

**AKT THEMELIMI DHE STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Hotel Prishtina-1”SHPK**

Ne Lezhe sot me date 02. 05.2024, ne mbeshteje te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërit Tregtare”,”Statuti" te Ligjit nr.7580 date 29.07.1994 “Kodi Civili Rrepublikes se Shqiperise”,ligji nr.9723 date 03.05. 2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”

Sot me daten 02. 05.2024 ne Ortaket e Shoqerise themeluese:

1. **Z. Jeton QAMILI** lindur ne me 12.10.1985 ne kosove Gjilan dhe banues ne Kosove, Malishev, me nr personal **1500439765** dhe numer leter njoftimi **ID0272086**.
 2. **Z. Rilind SHKODRA** lindur ne me 19.10.1993 ne kosove, Gjilan dhe banues ne Kosove, Gjilan, me nr personal **1232279091** dhe numer leter njoftimi **ID1522212**.
- Krijuan një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar me emrin “ **Hotel Prishtina-1**” **SHPK**
 - Shoqeria e themeluar do te zhvilloje aktivitetin ne baze te kerkesave ligjore ne fuqi dhe sipas permbajtjeve te ketij Akti Themelimi dhe Statuti.

Neni 1-Emri i Shoqerise dhe adresa

Kjo shoqeri do te emertohet “**Hotel Prishtina-1** ” **SHPK** dhe seline e saj do ta kete ne Adresen :

Shengjin; Rruga Kunes,ndertesa ne Zona Kadastrale Nr 1987, me nr. pasurie 3/750

Transferimi i selisë së Shoqërisë ne një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si edhe jashtë saj.

Neni 2 -Kohezgjatja

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise sone do te jete pa afat.

Neni 3 - Objekti / qellimi:

Objekti I Veprimtarise se Shoqerise “ **Hotel Prishtina-1** ” **SHPK** , eshte ne perputhje me ligjislacionin Tregtar aktual Shqiptar dhe dote jete :

Hoteleri, Struktura Akomoduese, shazllone dhe çadra per pushuesit, si dhe çdo veprimtari tjetër tregtare të lejuar nga legjislacioni Shqiptare.

Neni 4 – Kapitali i Shoqerise

Kapitali i Shoqerise “ **Hotel Prishtina-1**” **SHPK** eshte 100.000 (njqind mije) leke,i perbere nga 2 kuota.

Pjesemarrja e themeluseve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

1. Ortaku z. **Jeton QAMILI** eshte mbajtes i 1(Një) Kuote, me perqindje pjesemarrje 50% më vlerë 50.000 (Pesedhjetë mije) Leke.
2. Ortaku z.. **Rilind SHKODRA** , eshte mbajtes i 1 (Një) Kuote, me perqindje pjesemarrje 50% më vlerë 50.000 (Pesedhjetë mije) Leke

Kapitali i shoqerise “ **Hotel Prishtina-1**” **SHPK** eshte i papaguar.

Neni 5 – Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

Ne kuptimin juridik formal Shoqeria “ **Hotel Prishtina-1**” **SHPK** aktualisht drejtohet nga Asambleja e Ortakuve “ **Hotel Prishtina-1** ” **SHPK** . Kompetencat , te drejtat dhe detyrat e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve percaktohen ne nenin 81 te ligjit 9901, dt. 28.04.2008 “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”.

Asambleja e Pergjithshme Ortakeve, eshte organi i vetem qe merr vendime dhe miraton cdo ndryshim te statutit , gjithnje sipas modaliteteve qe parashikohen nga ligji . Cdo ndryshim i statutit duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Biznesit me qellim qe keto ndryshime te pasqyrohen ne regjistrin e shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve thirret , mblidhet dhe merr vendime sipas normave qe percaktohen ne ligjin no. 9901, date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” i ndryshuar.

Neni 6 – Marrja e vendimeve

Asambleja e Përgjithshme Ortakeve vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve, siç percaktohet ne piken 1 të nenit 87 të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe

shoqerite tregtare “ , për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Neni 7 – Administratori

1.Asambleja e përgjithshme emerion një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

2.Administratorët e një shoqëri tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3.Administrator I Shoqërisë “ **Hotel Prishtina-1**” SHPK emrohet **Z. Jeton QAMILI** i biri i Rabitit i datelindjes 12.10.1985 lindur ne Kosove,Gjilan dhe banues ne Kosove,Malishev, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar i identifikuar nepermjet Karte Identiteti nr.personal **1500439765** , me nje afat 5 vjecar me te drejte riperseritje.

Specifikimet e Administratorit

Afati emerimit te administratorit është per nje periudhe kohore prej 5/pese vitesh, me te drejte ripërteritje.Emerimi i administratorit do te prodhoj efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

1-Administratori duhet te ushtroj detyrat e ngarkuara, duke respektuar detyrimet e besnikerise, sipas neneve 14,15,17 dhe 18 te ligjit no. 9901, date 14.04.2008.

2-Administratori është pergjegjes ndaj shoqërisë per cdo veprim ose mosveprim te tij, qe lidhet me verpimtarine e shoqërisë.

3-Nese administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale është i detyruar t`i demshperblej shoqërine demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes.

4-Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tij ne menyre te rregullt.

Neni 8 – Perfaqesuesi Ligjor

-Shoqëria me pergjegjesi te kufizuar “ **Hotel Prishtina-1**” SHPK perfaqesohet nga administratori emeruar i saj z. **Jeton QAMILI**.

- Administratori është dhe përfaqësuesi ligjor i shoqërisë .

Neni 9 - Viti Financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor. Përfundimisht viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 dhjetor.

Neni 10- Auditues Ligjor

Audituesi Ligjor ka për qëllim të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë gjithëvjetor ose periodik për rastet kur është i ngarkuar nga ortakët . Në përfundim të kontrollit Audituesi Ligjor përgatit raportin me shkrim dhe ua dorëzon Ortakëve për shqyrtim dhe miratim mbi bazën e të drejtës vendimore që kanë.

Neni 11 – Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria për përgjegjësi të kufizuar prishet :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, duke respektuar nenin 87 të Ligjit 9901 “Marrja e vendimeve”.

Neni 12 - FITIMET

Fitimet që rezultojnë nga bilanci që caktohen për rezervën ligjore deri vjetor, duke zbritur 5% (pesë për qind) që caktohen për rezervën ligjore deri në 10% (dhjetë për qind e kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumatat që Asambleja e Përgjithshme, vendos t’i vënë në dispozicion të shoqërisë, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara respektivisht.

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë edhe zbritje të veçante në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrje apo shpërndarje të fitimeve, plotësisht apo pjesërisht, për vitet e ardhshme financiare .

Neni 13– Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve do të jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14- Riorganizimi i shoqërisë Bashkimi –Ndarja

Shoqeria mund te ndahet ,bashkohet sipas vendimit te Asamblese se Pergjithshme ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit nr.9901 dt 14.04.2009 ``Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ``i ndryshuar.

Neni 15 – Dispozita Perfundimtare

Per ceshtjet e pavendosura ne Akt Themelimi dhe Statutin e shoqerise“**Hotel Prishtina-1**” **SHPK** do te referohet ne dispozitat e pergjithshme ligjore te ligjit Nr 9901,date 14/04/2008 “Per tregtaret dhe ShoqeriteTregtare”,i ndryshuar dhe normat e tjera ligjore ne fuqi,ne Republiken e Shqiperise.

Akti i themelimit dhe Statuti u redaktua ne dy kopje,duke pasur secila fuqi ligjore dhe u nenshkrua rregullisht nga Ortakete shoqerise “ **Hotel Prishtina-1**” **SHPK** .

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE “ Hotel Prishtina-1 ” SHPK

1. Jeton QAMILI



Lezhë me date 02.05.2024

2. Rilind SHKODRA

